



DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Data:	02.02.2017
Referencë:	
Për:	Kryetarin e Komunës z. Imri Ahmeti
Nga:	Heset Sahiti - Drejtor i DSHP-së
Lënda:	Raporti i muajit Janar 2017

Në bazë të përgjegjësiave dhe kompetencave gjatë muajit Janar 2017, DSHP-ja ka kryer punë dhe aktivitetet e veçanta që janë kërkuar sipas dinamikës së zhvilluar dhe kërkesave të parashtruara nga ana e qytetarëve dhe nga ana e institucioneve.

Kërkesat janë të paraqitura në mënyrë tabelore:

Pasqyra e lëndëve (kërkesave) për muajin janar				
Nr. i kërkesave të pranuar	Të zgjidhura	Të refuzuara	Në kompetencë	Në procedurë
11	7		1	3

- Janë dhënë përgjigje, pëlqime, njoftime të ndryshme sipas kërkesave të qytetarëve dhe institucioneve.
- Është përfunduar Raporti i punës së DSHP për vitin 2016 si dhe është bërë plani i punës për vitin 2017.
- Takim me Policinë e Kosovës njësia ne Lipjan për rrugët e bllokuara nga bora dhe mundësin e hapjes të të gjitha rrugëve në territorin e komunës së Lipjanit.
- Është formuar shtabi emergjent nga drejtorit përkatëse të komunës për dalje në ndihmë kompanisë KRM Pastrimi njësia Lipjan, ku janë angazhuar kompani tjera për hapjen e rrugëve
- Barazimi i të hyrave me kompaninë “Algemi” Sh.p.k e cila mirëmban dhe menaxhon me tregjet.
- Mbikëqyrja e rrugëve dhe e trotuareve në qytetin e Lipjanit si dhe rrugëve lokale ku për shkak të reshurave të borës dhe ngricave është vështirësuar komunikacioni.
- Mbikëqyrja e kompanisë KRM “Pastrimi” e cila bënë pastrimin e rrugëve dhe trotuareve në qytetin e Lipjanit, dhe të gjitha fshatrave të komunës nga bora.
- Mbikëqyrja e kompanisë “Eing Com” e cila bënë mirëmbajtjen e parqeve dhe parkingjeve në qytetin e Lipjanit.
- Janë përfunduar punët ne grumbullimin e te dhënave për sistemin e performancës komunale ne fushat e caktuara.
- Raport Drejtorisë së Prokurimit për vazhdim të planit dinamik për projektin hapja dhe zhavorrimi i rrugës ne Honrovce.
- Raport Drejtorisë së Prokurimit, KRM Pastrimit dhe Kryetarit të Komunës lidhur me pastrimin e rrugëve në territorin e komunës nga datat 6,7,8,9,10,11,12,13 Janar 2017.
- Vërejtje KRM Pastrimit për mos pastrim të rrugëve nga bora në fshatrat e Komunës së Lipjanit.

- Njoftim Drejtorisë së Prokurimit dhe KRM Pastrimit për vizitën në teren me datë 24.01.2017 rrugëve të fshatrave të cilat nuk janë pastruar nga bora.
- Janë përgatitë paramasa dhe paralogari: ndërtimi i shtratit të lumit në fsh. Banullë.
- Kërkesë për fillim të procedurës së Prokurimit: mirëmbajtja e rrugëve të asfaltuara në tërë Komunën e Lipjanit dhe rregullimi i shtratit të lumit në fshatin Banullë.
- Kërkesë DPUMM inicim të procedurës, hartimi i projektit detal zgjerimi i rrjetit të ndriçimit publik në rrugicat e qytetit të Lipjanit.
- Puna me palë.
- Punë tjera në teren sipas kërkesave të ndryshme të qytetarëve dhe institucioneve.

Janë kryer edhe punë të tjera sipas nevojës dhe kërkesës së DSHP-së me urdhër të Drejtorit.

Pasqyra e aktiviteteve të DSHP-së		
Nr	Lloji i aktivitetit	Nr.
1	Kërkesa, njoftime, pëlqime, përgjigje si dhe shkresa të ndryshme organeve brenda komunës dhe institucioneve tjera	16
2	Takime me përfaqësuesit e fshatrave	18
3	Përgatitja e paramasave dhe paralogarive	1
4	Takime zyrtare në Ministrinë e Transportit dhe Post-Telekomunikacionit	0
5	Takime zyrtare në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor	0
6	Takime zyrtare në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal	0
7	Vizita në terren	29
8	Pjesëmarrja në konferenca dhe trajnime të ndryshme	0
9	Pjesëmarrja në hapjen dhe vlerësimin e tenderëve	0